STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 12 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO NJOFTON LINJEN TELEFONIKE 24/7 TE NDIHMES PER SIGURIMIN E KATASTROFES PER TE NDIHMUAR QE BANORET E NJU JORKUT TE RIMEKEMBEN NGA URAGANI SENDI (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se linja telefonike për katastrofën e Departamentit të Shërbimeve Financiare tani do të jetë e hapur gjatë 24 orëve të ditës, shtatë ditë në javë për të ndihmuar banorët e Nju Jorkut që të rimëkëmben nga Uragani Sendi (Sandy). Linja telefonike, në 800-339-1759, mund t'u përgjigjet pyetjeve që kanë lidhje me sigurimin ndaj stuhisë dhe mund të ndihmojë që konsumatorët të paraqesin ankesat. Më parë, linja telefonike po funksiononte nga 8 në mëngjes deri në 8 pasdite gjatë ditëve të javës dhe 9 në mëngjes deri në 4 pasdite në fundjavë që menjëherë pas Uraganit Sendi (Sandy).

"Eshtë vendimtare që banorët e Nju Jorkut të marrin ndihmën e tyre të sigurimit sa më shpejt që të jetë e mundur për t'i ndihmuar që të rimëkëmben nga stuhia," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Kjo linjë telefonike do të bëjë të mundur që të kërkojnë ndihmë në çdo kohë gjatë ditës ose natës për çdo çështje që ka lidhje me sigurimin ndaj stuhisë."

Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), Kryeinspektor i Shërbimeve Financiare, tha, "Njerëzit paguajnë për sigurim në mënyrë që t'i mbrojë nga katastrofat si Stuhia Sendi (Sandy). Departamenti i Shërbimeve Financiare është duke vëzhguar reagimin e siguruesve dhe do të ndërhyjë kurdoherë që është e nevojshme për të ndihmuar pronarët e shtëpive."

DFS gjithashtu është duke dërguar qendrën e saj të lëvizshme të komandës në rajonet e goditura rëndë për të ndihmuar konsumatorët me pyetje e probleme mbi sigurimin dhe është duke ndihmuar me personel për qendrat e ndihmës për kasastrofën në shumë zona të goditura nga stuhia. Telefonuesit e linjës telefonike gjithashtu mund të drejtohen për në qendrën më të afërt të ndihmës për katastrofën që të mund të kërkojnë ndihmë personalisht. Pronarët e shtëpive që nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjet me siguruesit gjithashtu mund të paraqesin ankesa në http://www.dfs.ny.gov/consumer/fileacomplaint.htm.

Që nga stuhia, Guvernatori Kuomo (Cuomo) ka ndërmarë disa masa për të mbrojtur pronarët e shtëpive:

• Guvernatori njoftoi se pagesat e zbritura për uraganin nuk do të zbatohen për ndonjë dëm nga Stuhia Sendi (Sandy) që mbulohet nga sigurimi i pronarëve të shtëpive pasi Stuhia nuk kishte erërat e vazhdueshme me forcë të uraganit kur mbërriti në Nju Jork.

• Guvernatori drejtoi DFS-në që të udhëzojë siguruesit të pranojnë dokumentacionin e pronarëve të shtëpive, përfshirë fotografi dhe video, të humbjeve, në mënyrë që banorët të mund të hedhin mbeturinat që janë të nevojshme të hiqen për arsye të shëndetit dhe të sigurisë. Zakonisht, ndërmarrjet e sigurimit kërkojnë fillimisht një inspektim në vend përpara sesa të përpunohet një pretendim.
• Guvernatori drejtoi DFS-në që të vendosë një ndalim prej 30 ditësh për anullimin ose dhënien fund të policave të sigurimit të pronarëve të shtëpive dhe pronarëve të bizneseve të vogla në rajonet e goditura nga stuhia për çdo arsye, përfshirë mospagesën e premiumeve.

DFS u bën thirrje pronarëve të shtëpive që pësuan humbje të pasurive që të paraqesin pretendime të sigurimit pranë siguruesve të tyre shpejt dhe sa më shpejt që të jetë e mundur pasi ndodhin humbjet.

Pronarët e shtëpive u rikujtohet gjithashtu se dëmi nga përmbytja mbulohet vetëm nga sigurimi nga përmbytja, e cila është një program federal i administruar nga FEMA. Pronarët e shtëpive që kanë sigurim nga përmbytja dhe ka dëmtim nga përmbytja duhet të bëjnë pretendime nëpërmjet atij sigurimi.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418